

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ASARENT” Sh.P.K

THEMELIMI I SHOQERISE

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ASARENT” sh.p.k. themelohet sipas parashikimeve te ketij statute ne daten 10.1.3./2021.

EMERTIMI

Neni 2

Emertimi i tregetar i Shoqerise eshte “ASARENT” sh.p.k.

SELIA

Neni 3

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “ASARENT” sh.p.k eshte ne rrugen “Jusuf Vrioni”, Nd. 4, Hyrja nr. 1, Ap. 10, Njesia Administrative nr. 5, 1019, Tirane. Shoqeria mund te krijoj filiale edhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e shoqerise eshte e pa caktuar dhe/ose e pakufizuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise “ASARENT” sh.p.k. është:

- Veprimtari ne fushene dhenies me qera te mjeteve te transportit si makina, motore, minibus, autobus, kamion, mjete lundruese, etj.
- Veprimtari ne fushen e guidave turistike, brenda dhe jashte vendit.
- Veprimtari ne import-export, shitjen dhe blerjen e mjeteve motorike.
- Veprimtari ne ofrimin e sherbimeve te riparimit dhe mirembajtjes se mjeteve motorike, etj.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne masen 100,000 leke te reja, e ndare ne 3 kuota. Shoqeria mund ta shtoje ose pakesoje kapitalin e saj, sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve. Ortaket e shoqerise renditen si me poshte vijon:



- Z. Elsi Gjata, identifikuar me karte identiteti me nr. Personal J00517068I, lindur me 17/05/1990, ne Tirane, zoterues i nje kuote prej 34 % te kapitalit.
- Z. Sindi Sinemati, identifikuar me pasaporte me nr. Personal J01221056V, lindur me 21/12/1990, ne Tirane, zoterues i nje kuote prej 33 % te kapitalit.
- Z. Dhimiter Jani, identifikuar me pasaporte me nr. Personal J01227051L, lindur me 27/12/1990, ne Tirane, zoterues i nje kuote prej 33 % te kapitalit.

TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT

Neni 7

Ne rastin e transferimit te kuotave te kapitalit, ortakut qe kerkon te shese kuotat e tij te kapitalit duhet te njoftoje me shkrim administratorin i cili njofton menjehere Asamblene e ortakeve per cmimin e shitjes se kuotave te ortakut qe kerkon ti shese.

Cmimi i kuotave oferte per shitje duhet te vendoset ne baze te vleres reale te Shoqerise ne momentin e dhenies se te drejtes.

Ne qofte se brenda 30 diteve nga komunikimi i ofertes per shitje te kuotave te kapitalit te shoqerise asnjeri nga ortakët e shoqerise nuk shprehet per blerjen e tyre atehere kuotat oferte shitje mund ti transferohen cdo personi qe kerkon ti bleje.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme mes anëtarëve të familjes si dhe mes paraardhesve dhe pasardhesve.

Ne rast vdekje te ortakut, kuoten titullare te te ndjerit e trashegojne trashegimtarete e tij ligjor.

FORMA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT


Neni 8

Kontrata per transferimin e pjeses se kapitalit duhet te jete ne formen e aktit noterial dhe ne rast se pronari i ri nuk eshte ortak i shoqerise, duhet te deklarroje shprehimisht ne kontrate se eshte njohur me statutin e shoqerise dhe se eshte dakort me parashikimet e tij.

RRITJA E KAPITALIT THEMELOR

Neni 9

Kapitali themelor mund te rritet pa kufizim ne cdo moment dhe nje ose disa here, me votim te Asamblese e Ortakeve, me votues present apo perfaqesues qe permbajne mbi 3/4 e kapitalit themelor. Ne rastin e shqyrtimit te rritjes se kapitalit, te gjithë ortakët kane te drejten te nenshkruajne rritjen sipas kuotave qe posedojne.



ZVOGELIMI KAPITALIT THEMELTAR

Neni 10

Kapitali themeltar mund te zvogelohet me Vendim te Asamblese te Ortakeve, me votim te ortakeve prezente apo perfaqesuesve qe zoterojne mbi 3/4 e kapitalit te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit te shoqerise perballohet nga secili ortak ne menyre proporcionale sipas kuotave qe zoterojne. Asambleja mund te vendosi zvogelimin e kapitalit te shoqerise brenda limiteve te ligjit.

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 11

Ortaku ka te drejte te jete i informuar per sa i perket drejtimit te shoqerise, per t'u vene ne dijeni per bilancin vjetor dhe te kerkoje me shkrim shpjegime ose ato qe i jep Administratori gjate mbledhjes se Asamblese.

Secili nga ortaket qe nuk eshte administrator, ka te drejte te prezatoje dy here ne vit tek Administratori, pyetje te lidhura me probleme ekzistenca e te cileve ve ne dyshim vazhdimesine e aktivitetit shoqeror. Per sa i perket pergjegjesise se Administratorit do te informohet edhe eksperti kontabel i autorizuar.

Ne rastin kur shoqeria nuk ka nje ekspert kontabel te autorizuar, emerimi i nje eksperti kontabel mund te krijohet ne rruge gjyqesore nga nje ose me shume ortake

Nje ose me shume ortake, mund te kerkojne ne rruge gjyqesore emerimin e nje ose me shume eksperteve te ngarkuar per te prezantuar nje raport per nje apo me shume aktivitete administrative. Raporti i eksperteve do te dorezohet tek ortaket qe kane prezantuar kerkesen. Ose tek Administratori eventualisht tek ekspertet kontabel te autorizuar. Raporti do te prezantohet me vone ne mbledhjen pasuese te Asamblese.

Ortaket kane te drejte te informohen mbi ndryshimet ne perberjen e organeve drejtuese te shoqerise.

Secili ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter nepermjet aktit te perfaqesimit ne forme shkresore. me delegim me shkrim nga nje tjeter ortak. Akti i perfaqesimit do te kete vlere ligjore vetem per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, te dates se percaktuar ne aktin e perfaqesimit dhe per rendin e dites te asaj mbledhje.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 12

- 1-Asambleja e Pergjithshme.
- 2-Administratori.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 13

Organi vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme. Vendimet e saj ne maxhorance jane te detyrueshme edhe per ortaket qe mungojne ose qe jane shprehur ne kundertshtim duke perjashtuar rastet e te drejtes se tyre te kundertimit ne limitet e kohes dhe/ose ne format e parashikuara te ligjit.

Gjate periudhes, kur Shoqeria, mund te kete nje ortak te vetem, te drejttat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme do te ushtrohen nga ortaku i vetem.

KOMPETENCAT E ASAMBLESE

Neni 14

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimor i shoqerise i cili vendos per :

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen epasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

MBLEDHJA E ASAMBLESE

Neni 15

Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare të Republikës së Shqipërisë ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.



Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

ADMINISTRATORI

Neni 16

Shoqëria perfaqësohet nga administratori. Në emër të shoqërisë nënshkruan administratori i cili i bashkangjitet emertimit tregtar të shoqërisë emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij.

EMERIMI I ADMINISTRATORIT

Neni 17

Administratori i Shoqërisë "ASARENT" sh.p.k. emerohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave të ortakëve, pjesët e të cilave perfaqësojnë mbi 50% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, administratori mund të jete ortak në shoqëri ose jo.

Asambleja e përgjithshme mund të revokojë emerimin me shumicë votash. Në fazën e formimit emerohet administrator Z. Elsi Gjata, identifikuar me kartë identiteti me nr.

Personal J00517068I, nr. Leternjoftimi 035788288, lindur me 17/05/1990, ne Tirane dhe banues ne Tirane, per nje afat 5 vjecar.


Specimenti i Firmes se Administratorit: ECSE GJATA 

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

Neni 18

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme.
- administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë të përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
- nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
- dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.
- Administratori duhet të marrë aprovimin e Asamblese se Pergjithshme per transaksionet ose nenshkrimin e kontratave me vlere me te larte se 200 000 leke te reja.



USHTRIMI VETOR I SHOQERISE , BILANCI VJETOR, NDARJA E FITIMIT

Neni 19

Viti i aktivitetit te shoqerise mbyllet me daten 31 dhjetor. Ne fund te vitit administratori vijon me hartimin e bilancit me llogaritjen e fitimit dhe humbjes sipas normave te ligjit, duke e shoqeruar me nje relacion shtese per aktivitetin e shoqerise.

Çdo ortak ka te drejte te kete nga Administratori informacion mbi zhvillimin e puneve te shoqerise dhe te konsultohet me librat e shoqerise.

NDARJA E FITIMIT

Neni 20

Pasi te kete permbushur sic parashikohet ne nenin 77 te Ligjit 9901 te 18.04.2008, shoqeria me shumice te kualifikuar votash te Asamblese se Pergjithshme, aprovon ndarjen e dividenteve per secilin ortak. Netoja e nevojshme sic rezulton ne bilancin vjetor, duke hequr 5% (pese perqind) te destinuar si rezerve ligjore, deri sa te arrije ne 10 % (dhjete perqind) te kapitalit te shoqerise dhe te terheqjeve te mundshme te vendosura nga Asambleja, do te ndahet ndermjet ortakeve ne raport me kuotat e kapitalit qe disponon secili prej tyre.

TRANSFORMIMI I SHOQERISE

Neni 21

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar mund te kthehet ne shoqeri kolektive apo komandite ose ne shoqeri aksionere vetem me aprovim unanim te ortakeve.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Neni 22

Te gjitha konfliktet qe mund te lindin gjate ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, si te gjitha konfliktet ne pergjithesi midis ortakeve, ose nga midis ortakut dhe shoqerise, duhet te zgjidhen me mirekuptim, sipas parashikimeve te statutit te shoqerise. Ne rastin kur konfliktet nuk zgjidhen me mirekuptim, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, do te jete kompetente per zgjidhjen e tyre.

SHKRIRJA E SHOQERISE

Neni 23

Shoqeria shkrihet:

- ditën e shënuar në Vendimin e Asamblese për shkrirjen e shoqerise.
- ditën e shënuar në Vendimin e gjykates për shkrirjen e shoqerise.
- në raste të tjera, të cilat vendosen me ligj.

GJUHA

Neni 24

Ky statut eshte redaktuar ne Tiranë me date 10./1.3../2021 ne kater kopje origjinale ne Gjuhen Shqipe dhe nuk ka asnje verejtje nga ortaket e shoqerise.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 25

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut eshte komptence e Asamblese se Ortakeve qe te beje plotesimin e dispozitave te ketij statuti, si dhe shfuqizimin e atyre dispozitave te cilat behen te pavlefshem dhe jo-efektive. Ndryshimet statutore do te kryhen sipas parashikimeve te ketij statuti.

ORTAKET THEMELUES

Z. ELSI GJATA

ELSI GJATA



Z. SINDI SINEMATI

SINDI SINEMATI



Z. DHIMITER JANI

DHIMITER JANI

